



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**  
**Nr. 17 datë 20.7.2023**

**PËR**  
**MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/PËRDORIM, TË SIPERFAQES 0.3201ha NË**  
**EKONOMIN PYJORE “PRUEMOS SHELDI”, NGA STRA 104, NJ.A GURI ZI,**  
**FSHATI SHELDI, PËR AKTIVITETIN INSTALIM TË SHTYLLËS ERËMATESE**  
**PËR STUDIMIN E ERËS, AEROGJENERATORË, PËR NJË PERIUDHE 18 MUAJ**  
**për shoqërinë “Wind Stream sh.p.k”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 20.7.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nënin 27 pika 5, nënin 54 shkronja ‘e/1’ ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr. 115/2014 date 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverijes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligji nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM 559 datë 29.07.2022 për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, VKM nr.684, datë 02.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të Këshillit Ministrave “Për transferimin në pronesi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë, dhënien me qira/përdorim, të sipërfaqes 0.3201ha në ekonomin pyjorë “Pruemos Sheldi”, nga str. 104, Nj.a Guri zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 18 muaj për shoqërinë “Wind Stream sh.p.k” të detajuar si më poshtë:

Tabel përmbledhëse dhënie në përdorim/qira E.P Pruevos Sheldi, ngastra 104

	Vlera e përdorimit të rrugës /km	Vlera e përdorimit lek/ha/vit	vlera totale
sip/ ha/km	1 km	0.3201ha	140 847.6 (njëqind e katërdhjet mijë e tetqind e katërdhjet e shtatë pikë gjashtë) lekë
lek/vit/ha/km	35 000 lekë/vit	184 000 lek/ha/vit	
afati kohor	1.5 vite	1.5 vite	
totali	88 347.6 totali lek/ për 1.5 vite	52 500 lekë totali per 1.5 vite (18 muaj)	

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LUSHI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Denis Lesha**

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 11

Zbardhur me datë 21.7.2023